

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Shteti që konsumohet
ADRESA	https://albeu.com/lajme/opinion/shteti-qe-konsumohet/1030486/
BURIMI	albeu.com
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	28 shtator 2026, 08:33:04 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	28 shtator 2026, 06:26:36 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	dee00121d393ce30e066c1a21b73776d25df2c39cbfffb15cde0cb03738a762bd
TEKSTI	05e0d2d24397d4841529327c303e0c32489f7c2730a032f8e95237032db6edf9
PAMJA	f4fa12a4633d7deade0682956ad2ec5fa149fb6c6b662d012c77ec2dcff30626

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	ecbf5fe08e5f3ac1cd32fcdc97f49125551061b94661556c5b1297f15e347bb1
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	b28949f398f9c40f36f567d35f036ed2a879d9ccf77f144b0ee032f95e15789d
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/ecbf5fe08e5f3ac1cd32fcdc97f49125551061b94661556c5b1297f15e347bb1>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Shteti që konsumohet



nga Agim Jakupi

Nga Qeveria e Stabilitetit e vitit 1991 deri te Qeveria e Pajtimit Kombëtar e vitit 1997, Shqipëria ka kaluar disa momente kur përplasja politike ka vënë në provë jo vetëm partitë, por edhe vetë funksionimin e shtetit. Kriza e vitit 1997 tregoi se kur dobësohen institucionet dhe humbet besimi publik, një krizë politike dhe ekonomike mund të shndërrohet në krizë shtetërore.

Sot Shqipëria nuk ndodhet në kushtet e vitit 1997, por zhvillimet politike të kohëve të fundit kërkojnë vëmendje serioze. Polarizimi i thellë, përplasjet e vazhdueshme mes mazhorancës dhe opozitës dhe mungesa e një dialogu politik të qëndrueshëm krijojnë një klimë ku institucionet rrezikojnë të shihen gjithnjë e më shumë si instrumente të luftës politike dhe jo si mekanizma të shtetit.

Në këtë kontekst, rasti i ish-drejtoreshës së SHISH-it, Vlora Hyseni, merr një dimension të veçantë. Ajo është nën hetim dhe ndaj saj është caktuar masa e arrestit në shtëpi dhe pezullimi nga detyra, ndërsa ndër akuzat e ngritura është edhe ajo për zbulimin e akteve ose të dhënave sekrete. Detajet e informacionit që dyshohet se është nxjerrë nuk janë bërë publike dhe fajësia duhet të përcaktohet nga drejtësia.

Por pyetja politike dhe institucionale që ngre ky rast është shumë më e madhe se fati individual i një zyrtareje: Nëse informacioni i klasifikuar i shtetit mund të dalë nga institucioni që ka për detyrë ta mbrojë atë, sa të sigurta janë mekanizmat e kontrollit dhe sa funksional është shteti?

Kjo nuk është pyetje që duhet t'i përgjigjet propaganda e asnjë partie. Është një pyetje që duhet t'i përgjigjet vetë shteti: institucionet e sigurisë, drejtësia, parlamenti dhe mekanizmat e kontrollit.

Një shtet funksional nuk matet vetëm nga fakti se ka institucione me emër, drejtues dhe struktura. Ai matet edhe nga aftësia për të mbrojtur informacionin e klasifikuar, për të parandaluar abuzimin me pushtetin dhe për të ndëshkuar shkeljet kur ato provohen. Prandaj, rasti Hyseni duhet të shërbejë jo për të bërë gjyqin politik të një individi, por për të ngritur një pyetje shumë më të rëndësishme: a janë mjaftueshëm të forta institucionet

të fundit /



Audi A6 elektrik përshkon 1,338 kilometra me një...



Avokatët zgjerojnë bojkotin, nuk marrin pjesë në seancat për...



Rokadë në postet diplomatike në Prishtinë dhe Shkup, Denion...



Rreziku po shtohet? Shërbimi danez i inteligjencës...



IPAK kërkon shqyrtim të pavarur të gjyqimit ndaj ish-krerëve të...



Latimer: Kosova dhe SHBA-ja, aleate për sigurinë dhe...



Arresti i Vlora Hyseni/ Mbyllet mbledhja e Këshillit të Sigurisë...



ARTIKULL JOETIK?

Esim for Global | Esim for Europe | Esim for Caribbean | Esim for USA | Esim for Italy | Esim for Spain | Esim for Turkey | Esim for Germany | Esim for Greece | Esim for Asia | Esim for World Cup 2026 | Esim for Saudi Arabia | Esim for Egypt | Esim for United Arab Emirates | Esim for Balkans | Esim for Morocco | Esim for China | Esim for United Kingdom | Esim for Africa | Esim for Latin America | Esim for GCC Gulf Cooperation Council | Esim for Middle East | Esim for South America | Esim for Canada | Esim for Mexico | Esim for Japan | Esim for Albania | Esim for Kosovo | Esim for Switzerland | Esim for Tunisia | Esim for South Africa | Esim for Algeria | Esim for Portugal | Esim for Brazil | Esim for Argentina | Esim for Colombia | Esim for Hong Kong | Esim for Thailand | Esim for Macau | Esim for Malaysia | Esim for Vietnam | Esim for South Korea | Esim for Austria | Esim for Netherlands | Esim for Australia | Esim for Russia | Esim for India | Esim for Chile | Esim for Peru | Esim for Poland | Esim for North Macedonia | Esim for Sweden | Esim for Finland | Esim for Norway | Esim for Belgium

shqiptare për të mbrojtur shtetin edhe nga njerëzit brenda vetë sistemit? Sepse problemi më i madh nuk është vetëm kur një shtet sulmohet nga jashtë. Problemi fillon atëherë kur besimi, informacioni dhe përgjegjësia shtetërore fillojnë të konsumohen nga brenda.

Shtuar më 28.09.2026 08:26

Tags: [agim jakupi](#)



Bilanci një vjeçar i "Diellës"



Protesta qytetare – sistemi politik – Mbretëria



Dy mijë vjet mësim dhe ende nuk kemi mësuar!



Kim Mehmeti: Shqipëria e piktorit ngjan sikur është mëmëdhe i serbëve, jo i...



Ditmir Bushati: BE-ja nuk ka kërkuar numrin e Bashkive, sfida është...



Kur klienti të nxjerr karton të kuq



Nikolla Neranxi: Arkivoli ne shesh, kur populli varros një pushtet të mbaruar!



Analiza e Artan Fugës: Qytetarët kuptuan se pushteti i kishte braktisur....



© 2003 - Albeu Online Media. Të gjitha të drejtat janë të rezervuara!

Kërko...

Kërko

Kryesore

Erion Veliaj
Free Esim
Zgjedhjet 2025
Belinda Balluku
SPAK
Kombëtarja

Kategori

Lifestyle
Showbiz
Tech
Shëndetësi
Argetim
Enciklopedi

Linqet

Live tv shqiptare
Moti në Shqipëri
Travel
Horoskopi
Livescore
News from Albania

Tags

Edi Rama
Albania News
Ilir Meta
Piranjat
gazeta, tv, portale
Sali Berisha

Moti

Moti në Tiranë
Moti në Prishtinë
Moti në Shkup
Moti në Durrës
Moti në Prizren
Moti në Tetovë

© 2003 - Të gjitha të drejtat janë të rezervuara!

Kontakti | Kushtet e Përdorimit | Privacy Policy | Powered by: orihost.com

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.